

Bardhyl Demiraj

(LMU/München)

Enciklika “Inter Omnigenas” (2 shkurt 1744) – rrethanat e përfatimit dhe ndikimi i saj në arealin kulturor shqiptar të Veriut

1. Qerthulli problematik me diskutimin përkatës

Titulli i kumtesës sonë ngërthen në vetvete si objektin e studimit ashtu edhe qëllimin e tij. Jemi fokusuar në letrën enciklike të Papë Benediktit (= lat. <Benedictus>) XIV, datuar më 2 shkurt 1744 dhe e mirënjohur tashmë me fjalët e saj nistore “Inter Omnigenas”, me të cilën kreu i Selisë së Shenjtë iu drejtua *Venerabilibus Fratibus, dilectis Filiis, Archiepiscopis, & universo Clero & Populo regni Servoniae, aliarumque finitarum Regionum*.¹ Duke u përqendruar kryesisht në rrethanat e përfatimit si edhe në ndikimin e saj në jetën kulturore-fetare të bashkësisë katolike në arealin kulturor shqiptar të Veriut, shpresojmë të plotësojmë kështu atë përshkrim dhe analizë që është ndërmarrë ndërkohë, sado në mënyrë sporadike, në historiografinë ekleziastike të Kishës Katolike-Romake në hapësirën kompakte shqipfolëse.² Me këtë rast nuk mund të lemë pa përmendur edhe faktin që Papë Benedikti XIV iu rikthye kësaj letre dhjetë vjet më vonë, duke rimarrë në detaj një numër çështjesh të saj në letrën enciklike simotër “Quod Provinciale” (1 gusht 1754), çka tumir më së miri rolin dhe rëndësinë e saj në zhvillimet që përjetoi atëbotë jeta kulturore-fetare në gjithë rajonin.³

Titulli i kumtesës qartëson gjithashtu ngushtimin e tematikës në këtë studim vetëm në njërin pamje të vendit që mëton Papë Benedikti XIV në historinë ekleziastike shqiptare-arbëreshe, përkatësisht në rolin e tij vendimmarrës e -dhënës si *Pons Pontificus* në mbarëvajtjen e atyre proceseve të jetës sociale-kulturore, me të cilat përballej bashkësia katolike shqiptare në gjysmën e shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut. Një tjetër drejtim do të merrte studimi ynë, në rast se do të rroknim në të edhe bulën e njohur papnore “Etsi pastorolis” të shpallur dy vite më parë (26 maj 1742), me të cilën Papë Benedikti XIV ndërhynte me autoritetin e tij në rregullimin dhe paqëtimin grindjeve të përfuara në ushtrimin e ritit fetar në ato zona të Italisë së Jugut dhe Sicilisë, ku popullsia arbërishtfolëse i ishte bashkuar me kohë Kishës Katolike-Romake, veçse ruante në shërbesat e veta fetare, sikurse e ruan sot e gjithë ditën në shumësinë e vet, ritin e trashëguar bizantin.

Do të ishim sigurisht ende të paplotë, sikur të linim pa vënë në dukje në këto fjalë hyrëse edhe një episod sa të veçantë aq edhe domethënës në historinë e kulturës së shkrimit shqip e që ka të bëjë me një funksion të ri që fiton shqipja e shkruar në

¹ Një ekstrakt i kësaj enciklike mund të konsultohet në ASC SC Servia I, fol 362-365. Shih edhe Farlati, Daniele – Coleti, Jacopo: *Illyricum sacrum*, t. VII, 1817 172-176.

² Gjini, Gaspër: *The Shkup-Prisren Diocese through centuries*, Prishtinë 1999 171v; Demiraj 2013 63vv, 90vv.

³ Bartl, Peter: *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878-1912)*, Wiesbaden 1968 98.

gjysmën e dytë të shek. XVIII, bash në kohën e regjënimit të Papë Benediktit XIV për mbarë grigjën katolike-romake në botë, duke lejuar e mundësuar qoftë përdorimin e saj në korrespondencën zyrtare me instanca të tilla të larta si Kuria e Shenjtë dhe kreu i saj Papa, ashtu edhe botimin e dokumentacionit shqip në aktet e veta zyrtare.⁴

Asgjëmangut, kufizimi i temës në kumtesën tonë është bërë jo thjesht dhe vetëm për arsye të kohës që kemi në dispozicion, sikurse edhe për faktin që kjo letër enciklike shënon vërtet një pikë kulmore në rrjedhën e zhvillimeve që përjetonte Kisha Katolike-Romake dhe jeta kulturore-fetare e popullsisë së krishterë në Arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar në gjysmën e shek. XVIII, por edhe se materiali dokumentar i bollshëm që ruhet në Arkivin Historik të Propagandës (ASC), lejon të zhvillojmë këtë temë në detaj, çka i vjen përshtat edhe vetë temës qendrore të këtij tubimi: “L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide”. Shpresojmë dhe urojmë kështu të nxisim rezonancën e duhur në studimet kulturore-historike dhe antropologjike që përjetoj hapësira kompakte shqipfolëse përgjatë gjithë periudhës kur zuri rrënjë, hodhi shtat e mori jetë bash institucioni *Sacra Congregatio de Propaganda Fide* (1622), bash kur përjetojmë në vazhdimësi një rritje të dukshme të vëmendjes dhe përkujdesit të Kurisë së Shenjtë ndaj jetës kulture-fetare të bashkësisë katolike shqiptare në arealin në shqyrtim.⁵

1. Letra enciklike: qëllimi dhe rëndësia e saj

Letra enciklike ngërthen në vetvete një ndërhyrje të dytë e me thuajse të njëjtin mesazh që ndërmerre Kuria e Shenjtë, madje vetë kreu i saj Papa, në gjysmën e parë të shek. XVIII për mbarëvajtjen e praktikave fetare, të së drejtës kishtare-juridike sikurse edhe të normave morale në jetën e krishterë të bashkësisë katolike në arealin kulturor të Veriut, përkatësisht në rregullimin e marrëdhënieve të saj në jetën e përditshme me bashkësitë e tjera fetare dhe me institucionin e pushtetit lokal. Ecuri vendimi dhe gjykimi dëshmon referimi që bën Papë Benedikti XIV qysh në pikën e parë të enciklikës ndaj vendimeve të urdhëruara prej Kuvendit Provincial të Arbënit (Mërçinjë, janar 1703), për të cilin hyri atëbotë dorëzanë Papë Klementi XI, i ashtuquajtur “Albani” (= “Shqiptari”), dora vetë. Prashtu nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që Papë Benedikti XIV qysh në paragrafin e parë me natyrë vendimore të enciklikës përcjell urdhëresën që klerikët që vepronin në këto zona duhet të ishin jo vetëm të pajisur me librin e akteve të Kuvendit të Arbënit, por edhe – madje sidomos (!!!) – t’u përmbaheshin me rigorozitet vendimeve të tij në kryerjen e të gjitha praktikave kishtare, khs.:

“1. Debuerunt quidem pleraque ex iis, quae contra Fidei & morum puritatem inter istarum Ecclesiarum Fideles irrepsisse dicuntur, vel anteverti, vel introducta corrigi, atque emendari per satis notas Pontificii & Canonici juris sanctiones, & per Apostolicae Sedis decreta per organum Ven. Fratrum nostrorum S. R. E. Cardinalium negotiis propagandae Fidei praepositorum saepius emanata, potissimum vero per ea, quae statuta fuerunt in Albano

⁴ Papa Benedictus XIV, Opera omnia VII, Romae 1767 91, 121, 143, 166, 190.

⁵ Sikurse edhe në Jug në zonën e Himarës dhe të Bregut të Poshtëm. Shih Demiraj, Bardhyl: Zef Schirò në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII, në: “Studime” 12 [2005] 67vv.

Concilio, quod sub fel. rec. praedecessore nostro Clemente XI. ab istius regni Primate pro universo Clero & Populo Albaniae Serviae indictum & celebratum fuit. Ideoque praedictas omnes juris ecclesiastici, & Sedis Apostolicae leges vobis omnibus in memoriam revocantes, earumque studium & observantiam impense commendantes praedictum Concilium Albanum vestris praecipue rebus ac temporibus accommodatum & opportunum omnino teneri, ac per omnia observari praecipimus volentes, ut omnes istius regni Archiepiscopi, Episcopi & Missionarii, & reliqui animarum curam habentes aliquod illius exemplar apud se habeant, atque ad illius normam suos & populorum mores exigere studeant & conformare. Debuerunt quidem pleraque ex iis, quae contra Fidei & morum puritatem inter istarum Ecclesiarum Fideles irrepsisse dicuntur, vel anteverti, vel introducta corrigi, atque emendari per satis notas Pontificii & Canonici juris sanctiones, & per Apostolicae Sedis decreta per organum Ven. Fratrum nostrorum S. R. E. Cardinalium negotiis propagandae Fidei praepositorum saepius emanata, potissimum vero per ea, quae statuta fuerunt in Albano Concilio, quod sub fel. rec. praedecessore nostro Clemente XI. ab istius regni Primate pro universo Clero & Populo Albaniae Serviae indictum & celebratum fuit. Ideoque praedictas omnes juris ecclesiastici, & Sedis Apostolicae leges vobis omnibus in memoriam revocantes, earumque studium & observantiam impense commendantes praedictum Concilium Albanum vestris praecipue rebus ac temporibus accommodatum & opportunum omnino teneri, ac per omnia observari praecipimus volentes, ut omnes istius regni Archiepiscopi, Episcopi & Missionarii, & reliqui animarum curam habentes aliquod illius exemplar apud se habeant, atque ad illius normam suos & populorum mores exigere studeant & conformare.” (SC Servia I, fol 362r)⁶

⁶ Varianti italisht: “1. In verità, quelle cose che si dice si siano introdotte fra i fedeli di codeste Chiese contro la purezza della fede e dei costumi dovevano, per la maggior parte, essere prevenute o corrette ed emendate in forza delle sanzioni sufficientemente conosciute del diritto pontificio e canonico, dei decreti della Sede Apostolica emanati più spesso attraverso l’organo dei Venerabili Nostri Fratelli Cardinali di Santa Romana Chiesa preposti agli affari di "Propaganda fide", ma specialmente a motivo di ciò che fu stabilito nel Concilio Albanese che fu indetto e celebrato, sotto il Nostro predecessore di felice memoria Clemente XI, dal Primate di codesto Regno, per tutto il clero e il popolo di Albania e Serbia. Perciò, richiamando alla memoria a tutti voi tutte le predette leggi del Diritto Ecclesiastico e della Sede Apostolica e raccomandando molto di studiarle e osservarle, comandiamo che il predetto Concilio Albanese, adattato specialmente alla vostra situazione e all’opportunità dei tempi, sia in tutto mantenuto e dappertutto osservato, volendo che tutti gli Arcivescovi, Vescovi, Parroci e Missionari e gli altri che sono in cura d’anime in codesto Regno, abbiano presso di sé qualche copia di quel Concilio e cerchino di regolare e di conformare il loro comportamento e quello dei loro fedeli secondo quelle norme.” (<http://www.totustuustools.net/magistero/b14inteo.htm>)

Shqip: “1. Besa shum aso s’kçias, ç i kan dal per mâ t’madhe t’zez t’Serbīs e t’Shçypnīs, kunra Fejet e veseve t’dlira, ishin muit çysh n’fillim m’u prit e m’u nal me t’shejt me kanun t’Kishs e me forc t’sā urdhnimevet e msimevet, ç i jan dhan shpesh prej ksaj Selis Shêjte per goj t’Kardinajvet t’Kuvenit Shêjt t’Propagands, e mâ fort t’syllevet, ç i jan bā prej Konçillit t’Arbnīs, ç i n’dit t’Klementit Paps t’Njimdhetit prej Arçipeshkvit Tivarit t’parit t’Serbīs kje mledh, e krye per meshtarī e popull t’Shçypnīs e t’Serbīs. Pranej na m’njen ân tuj ju shtī ner men borxhn ç i keni me i knue e me i rujt taman syllet e lixht, ci mahen n’kanun t’kishs e urdhenimet bâmun prej ksaj Selis Shêjte; m’tjeter ân dona e

Vështruar në kah perspektiv, d.m.th. në zhvillimet e mëvonshme të jetës sociale-kulturore të bashkësisë katolike në arealin në fjalë, lejohemi të përsiasim pa mëdyshje të rastit, se vendimet e marra në Kuvendin e Arbënit, përkatësisht theksimi i tyre në enciklikën e (parë 2 shkurt 1744 dhe në të dytën, më 1 gusht 1754) të Papë Benediktit XIV do të mëtojnë në vazhdimësi rëndësinë dhe rolin e tyre parësor si sinorë orientues në aktivitetin e klerit katolik për ushtrimin e praktikave fetare dhe zbatimin e së drejtës kanonike të Kishës Katolike-Romake në ato treva. Mjafton të përmendim me këtë rast dy ribotimet shqip (dhe latinisht) të akteve të Kuvendit të Arbënit (Romë 1868², Romë 1872³), duke i mëshuar edhe faktit, që në botimin e tretë përkthyesi i këtyre akteve, Àt Engjëll Radoja, nuk mungon t'i përcjellë lexuesit në shtojcë edhe versionin e përkthyer shqip të vetë enciklikës së Papë Benediktit XIV.⁷

Në rast se shtojmë së fundi edhe rolin e vendimeve të marra në Kuvendin e (parë të) Arbënit së bashku me urdhëresat e ndërmarra në enciklikën e Papë Benediktit XIV (për zbatimin e tyre me përpikmëri) si sinorë orientues gjatë tubimit të dy Kuvendeve të tjera Provinciale të Arbënit, që u mbajtën në gjysmën e dytë të shek. XIX në arealin në fjalë (Shkodër 1871, 1895), nuk bëjmë gjë tjetër veçse nxjerrim njëherësh në pah edhe jetëgjatësinë e rrjedhës së një procesi shndërrimi largvajtës që përjetonte jeta kulturore-fetare (me kahe drejt orientalizimit, përkatësisht islamizimit) në arealin në fjalë qysh prej ngërthimit të hapësirës kompakte shqipfolëse në suazën e Portës së Lartë, e që gëzoi ndërprerjen e tij vetëm në fillimet e shek. XX falë shkëputjes së kësaj hapësire prej zgjedhës otomane.

Parë nga kjo perspektivë, letra enciklike e Papë Benediktit XIV nuk mund të përcillet ndryshe, veçse si pjesë e asaj pakete masash parandaluese që ndërmerre herë pas here dhe rast pas rasti Kongregacioni i Propaganda Fide-s dhe Kuria e Shenjtë për parandalimin e ecurisë së këtij procesi në arealin e Veriut, një proces ky që jemi mësuar ta lexojmë dhe citojmë në letërsinë shkencore si një lloj sinkretizmi fetar, i cili sendërtohet në arealin në fjalë me një larmi të tërë variantesh të laramanisë (= kriptokristianizmit) si një dukuri kulturore-fetare, e përftuar në kohë e hapësirë falë bashkëjetesës së qëndrueshme ndërmjet bashkësive të krishtera dhe atyre të islamizuara shqipfolëse.⁸ Bëjmë fjalë pra për një dukuri që ishte shtrirë ndërkohë në të gjitha fushat e jetës materiale dhe shpirtërore, duke depërtuar thellë në matriksin e kulturës etnike shqiptare, të rrënjosur në jetën farefisnore, madje në vetë bërthamën e saj, siç ishte familja tradicionale shqiptare.⁹ Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi,

urdhnojm, çī Konçilli i Arbnīs, i cili sidomos i sherben novojve e zāmaneve tuja, xhith unji t'mahet prej jush; tuj dasht, çī xhith arçipeshkvit, ipeshkvit, priftnit, e misionart, e xhith ata, çī kan barren e shpirtnavet, t'a kēn afer vedit kā nji kopje t'ktī Konçillit e çī xhith n'mnyr çī kalxon ky Konçill t'munohen me i regullue veset e veta e veset e t'Kshtenvet." (Radoja (bot.) KA³ 1872 99v)

⁷ Radoja (bot.): Konçilli i Dheut Shqypnīs, bāmun n'vjet 1703 n'koh t'Paps Shqyptarit, Klementit t'Njimdhetit. Disā emernāme dalun prej Romet mas Konçillit qi pērkasin kishvet t'Arbnīs. I ka qit shqyp Don Engjell Radoja. N'Rom [...] 1872 (= KA³)

⁸ Shih Bartl, Peter 1968 87vv.

⁹ Për një përshkrim të detajuar të kësaj shtuate në aktet e Kuvendit të Arbënit shih së fundi Bardhyl Demiraj: Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh pērmes dy etnonimeve. Tiranë 2014 110vv.

që në qerthullin e urdhëresave që ndërmerr Papë Benedikti XIV në enciklikën e tij dallojnë sidomos ato masa parandaluese të dhurimit të sakramenteve sidomos ndaj:

- martesave të përziera, me restriksionet e çfarëdo lloji qofshin, përkatësisht atyre martesave që celebrheshin pa praninë e meshtarit,
- pagëzimit të fëmijëve që lindnin prej sosh, sikurse edhe
- sjelljes së dyfishtë të shumë besimtarëve:
 - o që shpallëshin publikisht si myslimanë, përkatësisht
 - o jetonin publikisht si të tillë, duke marrë edhe emra myslimanë, duke shkuar për t'u falur në xhami, duke u bërë synet e duke mos pasur kujdes ndaj festave fetare të krishtera dhe ditëve të agjërit të detyrueshëm kristian, përkatësisht ndaj mosngrënies mish për ditë të premtë dhe të shtunë, madje edhe
 - o vdisnin si të tillë, duke lënë amanet të varroseshin në varreza myslimane,

por duke kërkuar gjithherë t'u dhuroheshin sakramentet kristiane "vetëm në fshehtësi" (= <solo occultamente>), qoftë edhe për respekt ndaj besimit fetar të të parëve.¹⁰

2. Rrethanat e përfimit të enciklikës: deponimet e Imz. Gjon P. Nikollë Kazazit pranë Kurisë së Shenjtë

Pa dashur të ndalemi në më shumë hollësi – qoftë edhe për arsye kohe – sa i përket vetë përmbajtjes së letrës enciklike me atë tubë të tërë urdhëresash, të shpërndara në plot 28 paragrafë, pasi mjafton t'i referohemi me këtë rast qoftë variantit origjinal ashtu edhe versioneve të përkthyer me besnikëri në shqip dhe italisht në disa burime bibliografike, sikurse edhe në portale të besueshme të internetit,¹¹ lejohemi të kalojmë tash në pikën e dytë të kumtesës sonë, të sinjalizuar qysh në titull e që ka të bëjë me rrethanat konkrete që nxitën hartimin e kësaj letrë enciklike, e cila nominalisht i drejtohet klerit të provincës kishtare (= <Regnum>) të Serbisë si edhe krahinave përreth, por që faktikisht parakupton masat udhëzuese në formë urdhërimi ndaj klerit katolik që vepronte kryesisht trevat shqipfolëse në Arqipeshkëvinë e Shkupit dhe në Provincën Kishtare të Arbënit.

Referimi i bërë në hyrje të enciklikës lidhur me rrethanat:

"[...] tum vero novissime per Ven. Fratrem Joannem Baptistam electum a nobis & constitutum Archiepiscopum Scopiae distinctus expressae ac paene ob oculos nostras expositae incredibili nos dolore affecerunt. [...]"¹²

¹⁰ Për shfaqje nga më të ndryshmet të sinkretizmit fetar dhe të laramanisë në trevat shqipfolëse shih ndër të tjerë Bartl, Peter 1968 87vv.

¹¹ Shih shën. 7 si edhe faqet: <http://www.documentacatholicaomnia.eu/04z/z_1744-02-02_SS_Benedictus_XIV_Inter_Omnigenas_IT.doc.html>; <<http://www.totustuustools.net/magistero/b14inteo.htm>>.

¹² Italisht: "[...] Ci furono spiegate con maggiori particolari e quasi mostrate ai Nostri occhi dal Venerabile Fratello Giovanni Battista, da Noi eletto e costituito Arcivescovo di Skopje [...]" dhe shqip: "[...] por tash von ato t'kçia, çu me goj t'vet na i kalzoj esber e si pasçyr na i çiti perpara sÿve ton i nërshmi vllà Gjon Pagzuesi, emnue e shenjue prej nesh arqipeshkv n'Shkup [...]"

na lejon të fiksojmë menjëherë si referues të situatës në këto treva Imz. Gjon Pagëzues Nikollë – Kazazin, i cili ndodhej në Romë, kur Papë Benedikti XIV në breven e tij të datës 13 shtator 1743 e emëron Arqipeshkëv të Shkupit dhe Vizitor Apostolik të gjithë Mbretërisë së Serbisë.¹³

Gjatë kërkimeve tona në Arkivin Historik të Kongregacionit të Shenjtë mbi këtë personalitet të klerit katolik dhe të kulturës shqiptare në gjysmën e shek. XVIII kemi mundur të izolojmë që kësaj periudhe qëndrimi të Imz. Kazazit në Romë i takojnë dy ndër shkrimet më të rëndësishme në veprimtarinë e tij si klerik intelektual dhe lëvruar i gjuhës shqipe. Këto janë botimi i doracakut shqip “Doktrina e Kërshten” (Romë 1743), si edhe një promemorie që Imz. Kazazi, ende në funksionin e vikarit të përgjithshëm të Arqipeshkvisë së Shkupit, i drejton Papë Benediktit XIV, në të cilën e përditëson atë me gjendjen e besimit dhe të aktivitetit të klerit katolik në atë dioqezë, duke u lutur njëherësh për ndërhyrje me autoritetin e tij papnor në marrjen e masave përkatëse për rregullimin dhe përmirësimin e saj.¹⁴ Të bashkëlidhura me problemet e shqyrtuara në këtë promemorie janë po aq të rëndësishme edhe disa deponime e kërkesa që ka bërë ndërkohë Kazazi gjatë qëndrimit të tij në Romë pranë Kurisë së Shenjtë.

Të gjitha këto ndërmarrje së bashku dëshmojnë vëllimshëm në disa fonde të Arkivit Historik të Kongregacionit të Shenjtë,¹⁵ goftë me riprodhimin e pjesës hyrëse të letrës origjinale të Kazazit dërguar Papë Benediktit XIV,¹⁶ ashtu edhe në formën e përmbledhjeve memoriale, që na paraqiten në tri variante të ndryshme¹⁷, e sidomos në protokollin e deponimeve me komentet përkatëse në njërën ndër mbledhjet mujore të Kongregacionit¹⁸. I gjithë ky material arkivor i bollshëm në sasi dhe cilësi dëshmon më së miri reagimin e menjëhershëm që nxiti ai qerthull problematik i parashtruar në të.

Një vështrim disi më i detajuar i protokollit të këtyre deponimeve¹⁹ të Imz. Kazazit i bën gjithsesi më se të qarta të gjitha ato masa në formë urdhërese që ndërmerr Papë Benedikti XIV në enciklikën e tij. Kështu p.sh. Kazazi bën fillimisht një përshkrim të thukët të dukurisë së laramanisë që sundonte ndërkohë në rajon. Sipas tij:

“1. [...] i cristiani colà sono di due classi: nella prima si comprendono i cristiani pubblici, che pagano il tributo al Turco, e sono soggetti ad ogni strapazzo, ed auaria per la Fede; e questi abitano nelle Citta, ed in alcuni Villaggi.

La seconda è di quelli, che non potendo, e non uolendo soggettarsi a pagare il tributo, ne a soffrire gl’oltraggi dei primi, professano interiorm.te la Fede cristiana, ma tanto nascostam.te, che taluolta il Padre non si palesa ai Figli, ne i Figli al Padre, e nell esterno si mostrano, e si

¹³ Demiraj, Bardhyl 2013 59vv.

¹⁴ Demiraj, Bardhyl 2013 63vv.

¹⁵ ASC SC Servia I 317-51 – Pj. II, dok. nr. 3; ASC Acta 1743 214, 301; ASC CP 97 320 – 373; ASC Fondo di Viena 45 252-4.

¹⁶ ASC SC Servia I 317r-324v– Pj. II, dok. nr. 3.

¹⁷ ASC SC Servia I, 325-42 – Pj. II, dok. nr. 4; ASC Acta 1743, 301.

¹⁸ ASC CP 97, 320-373.

¹⁹ Një përmbledhje e sistematizuar e memorandumit nga ana e sekretarisë së Kongregatës së Shenjtë kemi në: SC Servia I, fol 344-351: “Monsign. Gio. Nicolovich Eletto Arcivescovo di Scopia nella Servia rappresentò nel 1743 alla S.tà V.ra lo stato, e la pratica circa la religione cattolica in quel Regno, ed in primo luogo espose. [...]” [344r.]

fanno credere per Turchi, chiamandosi col nome turco; mangiando i cibi proibiti ne' giorni uietati quando si trovano alla presenza de' Turchi; alcuni uanno alle Moschee, si fanno alle uolte circoncidere per non essere riconosciuti per cristiani; interrogati alla Giustizia, rispondono esser turchi; e finalmente morendo, si seppelliscono nelle sepolture de' Turchi con le cerimonie, ed assistenza de' med.mi.

Dall'altra parte nelle loro case professano la Fede Cristiana, battezzano i loro Figli, ai quali continuamente inculcano la costanza in simile fede di Cristo, si confessano, si comunicano, si cresimano; osservano le Vigilie, e quaresima con molto rigore; e fanno celebrare delle Messe per i loro Defonti, e pretendono di esercitare tutte le altre opere da Cristiani, ma solo occultamente.

De simil sorta de' Cristiani ne sono molte migliaia nella Servia, e nell'Albania le Mogli di essi sono p(er) lo più publicam.te cristiane, purché non siano figlie di Cristiani occulti, o di Turchi, e convertite poi in casa de' loro Mariti Cristiani; nel qual caso anche esse hanno il nome turco.

Nonostante però, che le disposizioni de' Concilj Provinciali, e le risposte date altre volte dalla Congreg.ne di Propaganda dichiarino tali Cristiani incapaci di Sacramenti, pure i Vescovi, ed i Missionarj Secolari, e Regolari hanno ammesso, ed ammettono i detti Cristiani a tutti i Sacramenti della Chiesa.

L'Esponente pertanto senza entrare a discutere, se le d.te canoniche disposizioni siano chiare, o ambigue, rappresentando lo stato, e la pratica di quei cristiani, e dei Sagri Ministri, poneua in considerazione, che non essendoui modo di ritrarre i detti Cristiani dall' incauto loro uiuere, qualora gli si negassero i Sacramenti, e gli si dicesse, di nulla giouargli tal professione di Fede, e gli si negasse l'applicazione delle Messe per l'anime dei loro Defonti, disperati si sarebbero affatto separati con le loro famiglie di generazione in generazione dalla Fede cattolica; anche in tale stato di cose chiedea alla S.tà V.ra un' ordine chiaro, e chiarissimo di non ammettere tali Cristiani alla partecipazione de' d.ti Sacramenti; poiche non emanando tal' ordine positiuo, non permetterebbero i Sagri Operarj, che tante migliaia d' anime si allontanassero affatto dalla S. Fede, e le ammetterebbero ai S. Sacramenti, come fin' a quel tempo aueuano fatto." [fol ...]

Në paragrafët e tjerë të deponimit Kazazi rreket të qartësojë situatën lidhur me shfaqjet konkrete të sinkretizmit fetar, përkatësisht të laramanisë, duke u lutur për udhëzime dhe urdhëresa të qarta të Atit të Shenjtë ndaj klerit në terren në kuptimin, se si duhet të veprojë në rastet përkatëse lidhur me dhurimin e sakramenteve. Kështu, sa i përket rasteve të ndryshme në martesat e përziera, në deponim mësojmë, ndër të tjera, se:

"2. Rappresentò in secondo luogo l'Eletto di Scopia, che molte Donne Cattoliche sono Mogli dei Turchi, ai quali i Genitori le danno o per forza, o per non comparir Cristiani, o per amicizia, o per interesse, o per altro fine mondano.

Molte di queste sono maritate senza contrarre il Matrimonio secondo il rito Cattolico, perché ne uengono riputati incapaci i loro Mariti per non auere il battesimo, o benche battezzati nell' infanzia, alleuati poi alla Turchesca, non uogliono contrarre il Matrimonio in presenza del Sacerdote, o benchè uogliono, non ardiscono, o non hanno il modo, onde lo contraggono nel rito Turchesco col caddi.

A tali Donne i Missionari non amministrarono i Sacramenti sino all' anno 1738, perché le giudicavano come in stato di concubinato, ma molte di queste dopo auere aspettato molti anni, uedendosi escluse dalla Chiesa, per disperazione rinegauano la Fede.

Suppone l'Esponente, che per rimediare alla perdita di tante anime emanasse un decreto dalla Congreg.ne di Propaganda, che permettesse l'amministrarsi i Sacramenti a tali Donne, purchè non fossero sopraggiunte ad altra Moglia, ne ui fosse *contemptus Fidei*, per la ragione, che quantumque in questi Matrimoni non ui sia il Sacramento, ui rimane però il contratto

civile; Servendosi pertanto della notizia del d.to decreto (quale in quelle parti più non si troua) hanno li Missionari amministrato i Sacramenti a tali Donne, et uice uersa anche agl' uomini Cattolici, che hanno le Mogli Turche, che non possono, o non uogliono contrarre auanti il Sacerdote, e proseguirebbero ad amministrarli, quando la S. Sede non glielo proibisca espressamente."

Gjithashtu, lidhur me dhurimin e sakramenteve në rastet e martesave të përziera në ato variante të shumta të laramanisë:

- "3. Propose, se si poteuano amministrare i Sacramenti ai Coniugi Cristiani (che sono gli occulti) ed uno di essi è Turco, il quale non solo non hà contratto il Matrimonio auanti il Caddì, o sia la Giustizia Turca, ma solo hanno fatti i legittimi sponsali con nome di publico Maritaggio, e con le Nozze.
4. Se si possano amministrare ai Coniugi Cristiani, che ambedue, o Uno di essi è Cristiano occulto, che non hanno contratto ne col Sacerdote, ne col Caddì.
5. Rappresentò esser solito amministrarsi i Sacramenti a quelle Donne, che essendo battezzate, e maritate ai Turchi anche senza il Matrimonio Turco, uiuono da Turche, e non ardiscono palesarsi per Cristiane, e solo nell' interno ritengono uiua la Fede Cristiana; di maniera che trouandosi alle uolte nelle case de' loro Genitori Cristiani, e capitando il Sacerdote, si accostano alla Confessione ne potersi escludere per non farle disperare, e separarle eternamente dalla Fede.
6. Disse in oltre, che anche i Cattolici pubblici sogliono contrarre per Procuratorem il Matrimonio auanti il Caddì, o la Giustizia per maggior ualidità del contratto, acciò non gli uenghino rapite le Mogli, ma poi sempre lo celebrano in faciem Ecclesie.
7. Se si possa dispensare nei gradi di parentela con quei Coniugi, l'uno de' quali sia Turco, e non abbino contratto ne coram Sacerdote, ne col Caddì; e la parte Turca non possa, o non uoglia celebrare col nostro rito, Supposto che questi tali si ammettino alla Confessione.
8. Per inueterato costume quei che assistono al Matrimonio si tengono per Compari e credono sennissimamente, che tra questi, ed i loro Figli interuenga la cognizione spirituale, e perciò non possa trà essi contrarre il Matrimonio.

si edhe:

11. Non si fanno nei Matrimoni i proclami, ma solo alcune pubblicità un' anno o mezzo anno prima de' Sponsali seruono di proclami senz' altre formali denunzie."

Lidhur me kumbarët në ceremoninë e martesës, të pagëzimit dhe të prerjes së flokëve, Kazazi kumton se:

- "9. Tengono nella stessa maniera per compari quei, che tagliano ai Fanciulli i primi capelli: e nella Seruia fanno la Cerimonia di tagliare i capelli con la benedizione posta nel fine dell' Epistole, e degli Euangeli, che in lingua illirica si leggono nelle chiese di Dalmazia.
10. I Compari poi del Battesimo, e della Cresima tengono, che non possino contrarre il Matrimonio sino al. 3°, e 4° grado. Alcuni Missionari per lasciarli nella buona fede, secondauano questa loro opinione; altri poi la rifiutauano secondo il Concilio di Trento; da ciò nasce dello Scandalo trà i Cristiani, si proponeua un modo, con cui tutti fossero di un sentimento."

Sa i përket çështjes së pagëzimit të fëmijëve që lindin në këto lloje martesash, Kazazi deponon:

- "12. Si battezzano i Figli di quei Turchi, che hanno le Mogli Cristiane, benchè senza speranza che seguitino la Religione Cristiana, ma solo per le istanze delle loro Madri per non farle, in caso di negastua, rinnegare, e sul riflesso, che morendo i Bambini prima dell' età adulta, potrebbero saluarsi.

13. Si vuole alle uolte battezzare i Fanciulli con la sola infusione senza le cerimonie, che si rifaranno a tempo piu comodo, e ciò o per fretta, o per mancanza di Padrini, o per timore dei Turchi.
14. Molte uolte i Sacerdoti stessi fanno da battezzanti, e da Padrini in mancanza di Compari, specialmente oue sono occulti."

Ndër problemet e tjera që shfaqen si pjellë e sinkretizmit fetar, përkatësisht e bashkëjetesës me komunitete të tjera fetare në këto treva, si edhe për disa vështirësi që i dilnin klerit gjatë praktikave fetare në terren, Kazazi vëren:

- "15. Se i Cristiani pubblici possono andare alle nozze de' Turchi nei tempi proibiti dalla Chiesa, douendo a queste taluolta andare per conuenienza.
16. Occorrendo alle uolte di fare degl' Esorcismi, che non sono nel rituale romano, come per quelli, che sono impediti ab actu matrimoniali, di maledire gl' animali nociui alle Campagne &; Se sia lecito perciò servirsi d' altri libri fuori del d.to rituale, come del Sannig, che contiene quasi tutte le benedizioni, ed Esorcismi del Circulus aureus.
17. Si battezza coll' acqua benedetta col Sale con la benedizione ordinaria nel fine del Messale; ne si bene dice a tenore del Rituale per non potersi fare in ogni luogo oue scorra il Missionario, e per la grande Scarsezza degl' ogli Santi, che vi faceuan di rado.
18. La Communione Pasquale suol cominciare nei Villaggi nel primo giorno di quaresima sino alla Pasqua ed a molti Villaggi si differisce sino alla Pentecoste, e ciò per la Scarsezza dei sacerdoti.
19. Per non esserui Chiese non si conserua in alcun luogo il SS.mo Sacramento, e perciò non si suol dare ai Moribondi; nelle città oue risiede il Sacerdote, uiene chiamato questo dall' interno, il quale sentendo la messa, fa la Comunione, che gli serve di Uiatico se muore.
20. I Cadaueri prima di seppellirsi si lauano e poi si inuoltano nelle sindoni, e ciò per non contrarre abominazione presso i Turchi, che anch' essi li lauano, e cantano molte preci a uicenda, e brugiano mirra; cosi i cattolici mentre li lauano, cantano le litanie de' santi, ed il miserere, e le Donne brugiano incenso nel lauare le morte.
21. È uso recente in qualche città di portarsi a seppellire i Cristiani laici defonti col capo auanti come i sacerdoti, e ciò per eludere le calunnie de' Turchi, i quali dicono per sedurre i Cristiani semplici, che i Sacerdoti in morte fanno la professione di Maometto, e rinascendo alla uita si saluano, e che perciò sono condotti a seppellire non come gl'altri Cristiani, ma col capo auanti."
- (22.) Rapresentò finalmente alcuni casi particolari, per i quali occorreua la Dispensa da concedersi particolarmente dalla S.tà U.ra, come di una Dispensa super impedimento iustitie publice proveniente ex matrimonio rato, et non consumato inter consanguineos coniunctos in primo gradu affinitatis.

3. Recepioni i enciklikës në radhët e klerit vendor dhe te laramanët

Përmbledhja e deponimeve mbyllet në fund me vërejtjen e sekretarit:

"A queste rappresentanze fatte dall' Arciuescouo di Scopia, la Santità U.ra hà pienam.te proueduto colla sua Sapientissima Decretale diretta al Clero, e Popolo di Seruia in data de 2 Febbraio 1744."

Siç mësojmë edhe nga data e shpalljes së letrës enciklike, kemi të bëjmë me një reagim brenda një kohe të shkurtër, pra të menjëhershëm të Papë Benediktit XIV ndaj situatës së Kishës Katolike-Romake dhe mënyrës laramane të jetesës për një përqindje aspak të vogël të bashkësisë (në shumësinë e vet) shqipfolëse në këto treva. Urdhëresat e parashikuara në të (shih § 1) dëshmojnë qartë ashpërsinë e këtij reagimi ndaj të atyre shfaqjeve të sinkretizmit fetar që sendërtonin së bashku dukurinë e

laramanisë, si faza e fundit që mund a duhej t'i paraprinte asimilimit të plotë, përkatësisht islamizimit tërësor të kësaj shtrese sociale. Nuk është pra për t'u habitur që në urdhëresat e tij ndaj klerit vendor, Papa Benedikti XIV përjashton prej dhurimit të sakramenteve fetare të gjithë laramanët, posaçërisht ata që: a) mohonin publikisht (d.m.th. para kadiut) fenë e krishterë; b) martoheshin me myslimanë; c) mbanin emra myslimanë; d) shkonin e faleshin ende në xhami; e për më tepër d) bëheshin synet; dhe f) hanin mish në ditët e ndaluara kristiane etj.

Këto masa të rrepta i linin pak ose aspak hapësirë klerit vendor në praktikat e veta fetare, sidomos në dhurimin e sakramenteve, sikurse edhe kësaj pjese të bashkësisë fetare shqipfolëse (laramane) në këto treva, e cila rrekej të ruante dhe konservonte zakonet dhe traditat në mënyrën e krishterë të jetesës, duke besuar qoftë edhe në fshehtësi në Krishtin. Andaj edhe reagimi i Papës me këtë enciklikë – siç mund e do marrë me mend – nuk u mirëprit aspak me ngazëllim e hare qoftë në radhët e klerit vendor, ashtu edhe prej popullsisë laramane (shqipfolëse). Për këtë situatë na informon vetë deponuesi i atyre rrethanave, që nxitën hartimin e letrës enciklike, shi Imz. Gjon P. Nikollë Kazazi në relacionin e tij (të fundit) triennial, që ia dorëzoi Kongregacionit më dt. 24 shkurt 1750 gjatë vizitës së tij (po të fundit) në Romë,²⁰ ku ndër të tjera shkruan, se:

"[fol 314] E incredibile l'odio, l'auersione, e l'esecrazione, che hò incorso appreso tutti li popoli, che sono occulti non solamente nella Seruia, ma eziandio nelle Diocesi di Scuttari, di Sappa, di Alessio, e di tutta l'Albania, Macedonia, non cessando di mandar contro di me mille maledizioni, contumelie, ed esecrazioni, condire, che io abbi ciò palesato al Papa, e che io sia stato la cagione di essere emanata la costituzione, che proibisce à loro l'amministrazione delli sacramenti: tantaché non possono vedermi mai con buon occhio; E non solo i secolari ma anche sino i sacerdoti, e Religiosi incolpano di ciò me unicam.te appresso il popolo, e dicono, che abbi fatto male di auer ciò palesato alla S. Sede, e che sarò causa di perire tante anime, che cosi potevano occultamente mantener la fede cristiana; in modo tale, che questi Popoli mi riguardano come nemico capitale, ne silurano, che vada di loro in visita: e se fosse loro lecito m'averebbero da lapidare, e sbrantar uiuo, quando sono stato da essi à fare la Visita.

Così mi successe fra l'altro à Babagni, ove sono da 40 e più grosse familie, à quali avendo fatto intendere, che non averei da confessare, e confermare quelli, che avrebbero da esercitare quei tali segni: In sentir ciò, ebbero da lapidarmi, e si fece un gran tumulto, e sollevazione dal Popolo di volermi scacciar via senza ne anche celebrare la Messa: e senza ne anche permettere di ricevere la cresima alle Donne, ed alli figlioli, come di sopra mi son spiegato. Alla fine poi raquietato al quanto il tumulto, permisero sotto sopra, che celebrassi, appena contendandosi di mandar li fanciulli alla cresima, che si cresmarono sino à 70, restando da cresimarsi quasi altri tanti che non li volsero mandare: con restare esclusi tutti l'altri adulti, che non potevano attenersi da quelli segni protestativi del Maumetismo compito ciò tumultuosamente; e con molta amarezza, l'ebbi per grazia speciale quando uscì à salvamento da quel luogo.

²⁰ ASC SOCG, vol. 743, fol 313 – 321: "Relazione della visita generale della Diocesi di Scopia nel Regno della Servia, presentata dall Arciv.o di Scopia, et Amministratore di tutto il Regno della Servia per lo triennio 55"

Peggio mi successe in un altro luogo detto Budacova, dove da 30 anni erano scorsi, che non vi era stata la cresima, e per l'istessa ragione mi scacciarono, senza permettermi à far la cresima ne anche alle donne, ed alle figliole, che potevano cresimarsi: A segno tale che non uoleuano neppure, che celebrarsi la Messa, la qual tuttavia col consenso del Padrone della casa fù celebrata senza farsi la Cresima, uergognosam.te fui in tal maniera scacciato con mille esecrazioni, e mal'animo, perche non uolsi amministrare i Sacramenti contro il diuieto della Bolla.

Di questa sorte di cristiani così occulti esclusi, dalli cattolici puliti professori della Fede Cristiana che si soggettano al tributo, et à tutte le angarie, e persecuzioni sino à spender il sangue per amor di Cristo, li quali compongono il largo uniuersale della cristianità in Seruia. Oltre di questi dico, sono di quella sorte di cristiani così occulti molte popolazioni addietro mentionate, molte popolazioni in diuerse parti della Seruia, doue 10, doue 20, doue 30, doue 40 ed 80 grosse Famiglie, le quali osseruano rigorosamente nelle loro case la quaressima, e gl'altri exercizj della Fede cristiana, con esser per lo passato stati ammessi alla partecipazione de'sacramenti, et ora dopo l'emmanazione della Costituzione sudetta sono irremissibilmente esclusi dai Sacramenti anco in punto di morte quelli, che han da sepellirsi con li Hoggia, e nelle sepulture Turche.

Circa lo stato infelice delle Donne in gran numero state conuertite per lo passato occultamente alla fede di Cristo siamo spiegati nelle precedenti relazioni."

Pasazhi i mësipërm qartëson atë reagim aspak fatlum si të klerit vendor ashtu edhe të asaj shtrese sociale (shqipfolëse), më se të konsiderueshme në numër, në të cilën kishte depërtuar aq thellë dukuria e laramanisë si pjellë e realitetit social dhe kulturor në këto treva,²¹ ku bëhej gjithnjë e më i vështirë recepsioni dhe tumirja e vendimeve dhe urdhëresave që vinin nga Kuria e Shenjtë dhe vetë Papa. Një reagim të ngjashëm do të përjetojë edhe letra e dytë dhe e fundit enciklike e shpallur 10 vjet më vonë (1 gusht 1754: "Quod Provinciale"), në të cilën Papë Benedikti XIV insiston që kleri katolik të zbatojë me rreptësi vendimet e Kuvendit (të Parë) të Arbënit sikurse edhe urdhëresat e dhëna në enciklikën e tij të parë,²² ndërkohë që këshillon ata të krishterë katolikë (të konvertuar), që nuk mund të përballonin më opresionin fetar, të shpërnguleshin në zona të krishtera.²³

²¹ Për dukurinë e laramanisë dhe ruajtjen e konservimin e zakoneve dhe traditave kristiane në grupe të ndryshme popullsish myslimane brenda dhe jashtë Ballkanit shih Bartl, Peter 1968 98.

²² Khs.: "4. [...] Se alcuni poi non ubbidiscono alle vostre esortazioni e ai nostri ordini, secondo la norma della disciplina Apostolica, devono essere obbligati con le maniere forti: su di loro devono essere applicate interamente le sanzioni e le pene del vostro Sinodo Albanese e della suddetta nostra Lettera, e sia loro dichiarato che non potranno ricevere, in vita, i Sacramenti, e dopo la morte, se saranno deceduti senza ravvedersi, i suffragi. Quelle pene Noi rinnoviamo e infliggiamo di nuovo, per quanto ce n'è bisogno, e vogliamo e ordiniamo che siano mandate a debita esecuzione da Voi. Questo poi non deve sembrare odioso a nessuno di voi, Venerabili Fratelli, Diletti Figli, poiché se la Vostra giustizia non supererà quella degli Scismatici ed Eretici, nessuno dei quali osa prendere un nome Maomettano, non entrerete nel Regno dei Cieli." (idem)

²³ "3. [...] Quindi proibiamo rigorosamente che qualunque Cristiano, per qualunque motivo o pretesto o in qualsivoglia immaginabile circostanza, osi assumere i medesimi nomi Turchi o Maomettani per farsi credere Maomettano. [...]

5. Infine, coloro che si sono fatti Cristiani dal Maomettanesimo, o che sono figli di convertiti, nel caso in cui diffidino della propria costanza nella Fede e abbiano timore di incorrere nelle pene dei loro Governanti se lasciano i nomi Turchi, e abbiano paura di subirle, esortateli seriamente ad abbandonare di nascosto quelle regioni e a venire a rifugiarsi nelle terre dei Cristiani, nelle quali non

5. Vëzhgime përmbyllëse

Enciklika "Inter Omnigenas" (2 shkurt 1744 bashkë me "Quod Provinciale" 1 gusht 1754) e Papë Benediktit XIV nuk gëzoi suksesin e shumëpritur prej Selisë së Shenjtë, në kuptimin që – sikurse edhe më parë vendimet e Kuvendit të Arbënit (1703) – nuk arriti të neutralizojë dukurinë e laramanisë si shfaqje e sinkretizmit fetar në ato treva të arealit kulturor të Veriut,²⁴ që ndanin së bashku prej shekujsh – herë me dhunë e herë në paqe – Kisha Katolike-Romake me Kishën Ortodokse dhe prej shek. XIV-XV edhe me Islamin. Mossuksesin afatgjatë në luftimin e kësaj dukurie e dëshmojnë qartë edhe dy Kuvendet e tjera të Arbënit në gjysmën e dytë të shek. XIX (1871, 1895) që kishin këtë dukuri në rend të ditës.

Në vlerësimin shkencor-kritik të kësaj dukurie mendimet janë të ndryshme, deri të kundërta, duke i mëshuar sipas rastit a) tolerancës deri intolerancës së fesë islame që depërtoi bashkë me sundimin osman, tolerant deri intolerant ndaj besimit fetar në Ballkan, sikurse edhe b) cektësisë së ndjesisë fetare den-baba-den ndër shqiptarë, të cilët gjëllikëshin tradicionalisht (vetëm) me mentalitetin e fisit dhe të gjakut farefisnor. Analiza të mirëfillta të karakterit historik-kulturor i ndeshim p.sh. në një numër punimesh të historianit Peter Bartl,²⁵ i cili në shtjellimin e kësaj dukurie si edhe për aspekte të tjera të sinkretizmit fetar në hapësirën shqipfolëse mban parasysh krahas faktorëve politikë e socialë-ekonomikë edhe infrastrukturën e Kishës si institucion bashkë me nivelin e ulët të përgatitjes së klerit katolik në rajon, sikurse edhe pamje të ndryshme të kulturës materiale-shpirtërore të bashkësisë etnike shqiptare.

Parë nga këndvështrimi i antropologjisë historike mendojmë se gjithë këto aspekte të sinkretizmit fetar që sendërtohen më së qarti në dukurinë e laramanisë janë pjellë e zhvendosjeve të brendshme që përjetoi matriksi i kulturës etnike shqiptare, e që gjejnë shprehjen më të qartë në shtimin e elementëve të rinj në përbërësit e tij themelorë, siç ishte p.sh. depërtimi në vazhdimësi i fesë islame në besimin fetar, sikurse edhe i tipareve orientale në mënyrën tradicionale të jetesës. Kjo dukuri solli si rrjedhojë relativizmin e pozicioneve të këtyre dy përbërësve themelorë në matriks, duke mundësuar kështu forcimin e rolit të gjuhës, si mjet komunikimi brenda bashkësisë, e cila në fillimet e shek. XVIII ishte shndërruar në përbërësin kryesor për identifikimin e vetë matriksit, përkatësisht dallimin e tij prej sosh të etnive fqinjë.²⁶

mancheranno ad essi né Dio che dà il cibo ad ogni vivente, né la carità dei fedeli, specialmente se saranno muniti di lettere di raccomandazione dei Vescovi." (idem)

²⁴ Për shfaqje të sinkretizmit fetar në jug të këtij areali, p.sh. në zonën e Shpatit, shih ndër të tjerë Bartl 1968 92; ndërsa për përpjekjet e Kongregacionit të Shenjtë në vendosjen e Kishës Katolike me rit bizantin në zonën e Himarës dhe në dioqezën e Durrësit, shih Borgia, Nilo: I monaci basiliani d'italia in Albania. Apunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII). Periodo secondo, Roma 1942.

²⁵ Bartl, Peter 1968 78vv.; „Albania sacra geistliche Visitationsberichte aus Albanien“ Bd. 1: „Diözese Alessio“. Wiesbaden 2007; Bd. 2: „Erzdiözese Durazzo“. Wiesbaden 2011; Bd. 3: „Diözese Sappa“. Wiesbaden 2014.

²⁶ Më hollësisht në Demiraj, Bardhyl: 2014 102-128.